

DREJTORIA E ARSIMIT

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-032), Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Nr. 04/L-138), Udhëzimin Administrativ të MASHTI-it (Nr. 22/2013) për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës, dokumentin nga MASHTI (Nr. 3/2838, datë 29.06.2026).

KONKURS PLOTËSUES (Afati i gushtit)

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale (Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional, IAAP) për vitin shkollor 2026-2027, sipas Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK).

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-032), Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Nr. 04/L-138), Udhëzimin Administrativ të MASHTI-it (Nr. 22/2013) për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës, si dhe dokumentin nga MASHTI (Nr. 3/2838, datë 29.06.2026).

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjimnazin "17 Shkurti" në Obiliq dhe SHMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq për vitin shkollor 2026-2027, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit që e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Republikës së Kosovës obligohen ta bëjnë njohjen (nostrifikimin) e certifikatave ose dëftesave në MASHTI përpara se të konkurrojnë.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën ku konkurrohet)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (klasat 6–9)
- Certifikatën e lindjes

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

- **Dorëzimi i dokumenteve:** Bëhet më datat **17, 18 dhe 19 gusht 2026**, në lokalet e shkollës përkatëse, nga ora 08:00 deri në 16:00.
- **Shpallja e rezultateve:** Rezultatet do të shpallen në shkollat përkatëse më **20.08.2026**.
- **Kthimi i dokumenteve:** Për nxënësit që nuk janë pranuar, kthimi i dokumenteve bëhet nga data **24.08.2026**.
- **Afati për ankesa:** Nxënësi i pakënaqur ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditëve pune nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa e shkallës së parë parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesa e shkallës së dytë bëhet në Drejtorinë e Arsimit brenda dy (2) ditëve pune pas pranimi të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi maksimalisht mund të fitojë **100 pikë (100%)**, të cilat ndahen si vijon:

- Suksesi nga shkollimi i obligueshëm: **40%** (maksimumi 40 pikë)
- Suksesi nga lëndët prioritare: **20%** (maksimumi 20 pikë)
- Numri i pikëve nga testi: **40%** (maksimumi 40 pikë)

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë së paku 4.00 (llogaritet mesatarja e lëndës për klasat 6–9, e pastaj mesatarja e përgjithshme e atyre lëndëve). Kriteri i lëndëve prioritare nga testi është minimumi 40% e pikëve nga ato lëndë.

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6, 7, 8, 9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit: $\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)} \times 2 = 40$
pikë maksimum

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

Formula: $\text{Mesatarja (I) + Mesatarja (II) + Mesatarja (III) + Mesatarja (IV)} = 20$
pikë maksimum

Lëndët me përparësi sipas drejtimeve:

- **Gjimnazi i Shkencave Natyrore:** Fizikë, kimi, biologji dhe matematikë
- **Gjimnazi i Shkencave Shoqërore dhe Gjuhësore:** Gjuhë amtare, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi
- **Lëndët me përparësi me sukses sipas profileve në IAAP (Elektroteknikë, Xehtari, Kimi – Teknologji dhe Gjeologji):** Matematikë, informatikë, fizikë, gjuhë shqipe dhe letërsi

4. Kriteri i suksesit të notave në lëndët me përparësi për drejtimet përkatëse

- Gjimnazi i Shkencave Natyrore:** Mesatarja e lëndëve fizikë, kimi, biologji dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% e lëndëve prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).
Formula: Mesatarja (kimi) + Mesatarja (biologji) + Mesatarja (fizikë) + Mesatarja (matematikë) ≥ 4
- Gjimnazi i Shkencave Shoqërore:** Mesatarja e lëndëve gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% e lëndëve prioritare në test (20 pikë nga lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi).
Formula: Mesatarja (gjuhë shqipe) + Mesatarja (gjuhë angleze) + Mesatarja (histori) + Mesatarja (gjeografi) ≥ 4

B. Përmbajtja e testit: numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve

Fusha	Lëndët	Pikët	Gjithsej
I. Gjuhë	1. Gjuhë shqipe	25 pikë	25 pikë
	2. Gjuhë angleze	5 pikë	
II. Shkencat shoqërore	1. Gjeografi	12 pikë	25 pikë
	2. Histori	13 pikë	
III. Matematikë dhe Informatikë	1. Matematikë	20 pikë	25 pikë
	2. Informatikë	5 pikë	
IV. Shkencat natyrore	1. Fizikë	8 pikë	25 pikë
	2. Kimi	8 pikë	
	3. Biologji	9 pikë	

5. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve

I. Gjimnazi i Shkencave të Natyrës:

1. Shkencat e natyrës –	25 pikë $\times$ 0.8 = 20 pikë
2. Matematikë & Informatikë –	25 pikë $\times$ 0.4 = 10 pikë
3. Gjuhë amtare & Gjuhë angleze –	25 pikë $\times$ 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkencat shoqërore –	25 pikë $\times$ 0.1 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

II. Gjimnazi Shoqëror:

1. Shkencat shoqërore –	25 pikë $\times$ 0.6 = 15 pikë
2. Gjuhë amtare & Gjuhë angleze –	25 pikë $\times$ 0.6 = 15 pikë
3. Matematikë & Informatikë –	25 pikë $\times$ 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkencat natyrore –	25 pikë $\times$ 0.1 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

6. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në shkollën profesionale

I. Makineri, Elektroteknikë, Xehtari, Gjeologji, Kimi – Teknologji:

1. Matematikë & Informatikë –	25 pikë $\times$ 0.8 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare & Gjuhë angleze –	25 pikë $\times$ 0.4 = 10 pikë
3. Shkencat natyrore –	25 pikë $\times$ 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkencat shoqërore –	25 pikë $\times$ 0.1 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

II. Ekonomi (Banka dhe Sigurime):

1. Matematikë & Informatikë –	25 pikë $\times$ 0.8 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare & Gjuhë angleze –	25 pikë $\times$ 0.4 = 10 pikë
3. Shkencat natyrore –	25 pikë $\times$ 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkencat shoqërore –	25 pikë $\times$ 0.1 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

Planifikimi i regjistrimit sipas shkollave (Afati i Gushtit)

Gjimnazi "17 Shkurti" në Obiliq

Nr.	Drejtimi	Numri i paraleleve të planifikuara	Numri i nxënësve për afatin e Gushtit
1.	Gjimnazi Natyror	2	32
2.	Gjimnazi Shoqëror	1	4
Gjithsej:		3	36

SHMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq

Drejtimi	Profili	Nr. Paraleleve	Numri i nxënësve	Vitet e shkollimit
Elektroteknikë	Energjetikë	1	8	2+1
Kimi – Teknologji	Xehtari	1	14	2+1
Kimi – Teknologji	Laborant i Kimisë	1	15	2+1
Gjeologji	Gjeologji	1	24	2+1
Makineri	Operator i prodhimit	1	19	2+1
Ekonomi	Banka dhe Sigurime	1	9	2+1
Gjithsej:		6	89	

Drejtoresha e DA-së: Sevdije Berisha Krasniqi

